



FJALA E FUNDIT
MBI SYNËTIN DHE BIDATIN



SINQERITETI



ISLAMI
NUK MUND TË JETË ALIBI
NË GOJËT E TË PAUDHËVE!

Viti XIV - Nr. 11 (165),
Nëntor, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

SY MË SY ME SHPIRTIN E QYTETIT TIM...



INTERVISTË ME IMAMIN E TRENTOS, DR. ABOULKHAIR BREIGHECHE

Jam shumë i shqetësuar për mënyrën me të cilën Evropa dhe në përgjithësi Perëndimi po sillet kundrejt minorancave islame. Është duke u përgjithësuar, duke arritur deri në atë pikë sa të konsiderohet prezenca islame në perëndim, si një rrezik.

Për fat të keq shembujt e asaj që po ndodh në disa raste janë edhe qesharake, duke nisur nga detyrimi që të hiqet mbulesa nga kokat e grave në Francë ose në rastin e fundit të ndalimit të veshjes së një kostumi banjoje për të notuar!?



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, i Cili urdhëron në Kur'anin Famëlartë: “Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoje gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre, sepse Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë.” – (El-Enfal: 63.)

Nëpërmjet këtij ajeti, vërtetoi se, vëllazëria e shenjtë islame, mbetet sirr, prej sirreve të dashnisë së Tij (xh.sh) për besimtarët e Tij, për racën njerëzore!

Salavatet dhe selamet më të përzemërta, ia dërgojmë sot, në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës sonë, Ma të Dashtunit e ma të Mirit, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s.), i cili urdhëronte: “I sheh besimtarët në dashamirësinë e tyre për njëri-tjetrin dhe në mëshirimin ndaj njëri-tjetrit, si një trup i vetëm; që, kur një prej gjymtyrëve lëngon, i gjithë trupi alarmohet dhe pezmatohet” – (Bukhariu dhe Muslimi.)

TË DASHUR E TË SHITUR, MOTRA DHE VËLLEZËR BESIMTARË,

“Ka një sulm të madh që i drejtohet fesë, pas shpine! ... Rruqa që kanë vizatuar për muslimanët, është largimi dhe distancimi nga feja e tyre dhe rregullat e saj, eliminimi i simboleve dhe emblemave! Kërkohet që të angazhohet në shoqërinë islame, të jenë një model, pa ngjyrë, pa shije dhe pa erë. Një lloj, që nuk njihet nga identiteti dhe ngjyresa fetare dhe ajo e moralit...!” – (El-Gazali, “El-gazvuth-thekafi jemteddu fi feragina”, botimi i parë, Kajro, 1998, f. 126)

Kështu shprehet Shejkh Muhammed El-Gazali, në librin e tij me titull: “Sulmi kulturor përhapet në boshllëkun tonë”.

ISLAMI NUK MUND TË JETË ALIBI NË GOJËT E TË PAUDHËVE!

Me fjalë të tjera, po të marrim në shqyrtim vetëm titullin e këtij libri, në kontekstet e hytbes së kësaj xhumaje dhe realiteteve të hidhura me të cilat përballemi sot, ne si muslimanë, kudo në botë, i bie, që gjithësecili prej nesh është të jetë i ftuar për të menduar e medituar thellë rreth këtyre ngjarjeve, me të cilat është rrethuar jeta e jonë dhe, të cilat po na befasojnë ditë pas dite për fytyrën e vërtetë të armiqësive të vjetra ndaj Islamit dhe muslimanëve, sidomos në vendin tone dhe perëndim!

Fatkeqësisht sot, edhe tek ne, ka një keqpërdorim të përhapur në masë të termit “Islami” dhe “musliman”.

sot! Muslimanët e Shkodrës, nuk janë dëshmuar ndonjëherë si vrshtarë e shkatërrimtarë, që të dëshmohen sot!

Prandaj, krejt këto propaganda të ulëta dhe përpjekje boshe, për ta lëkundur besimin tonë në fenë tonë të shtrenjtë islame, për ta frikësuar shoqërinë tonë ndaj Islamit, për ta larguar rininë e rrezikuar me dekadencë afetare, morale e shpirtërore; janë përpjekje të dështuara dhe njëkohësisht, vetëm se na zgjojnë nga gjumi i neglizhencës dhe indiferentizmit ndaj hakut të fesë në jetën tonë!

TË DASHUR TË PRANISHËM,

“KA NJË SULM TË MADH QË I DREJTOHET FESË, PAS SHPINE! ... RRUQA QË KANË VIZATUAR PËR MUSLIMANËT, ËSHTË LARGIMI DHE DISTANCIMI NGA FEJA E TYRE DHE RREGULLAT E SAJ, ELIMINIMI I SIMBOLEVE DHE EMBLEMAVE! KËRKOHET QË TË ANGAZHUARIT NË SHOQËRINË ISLAME, TË JENË NJË MODEL, PA NGJYRË, PA SHIJË DHE PA ERË. NJË LLOJ, QË NUK NJIHET NGA IDENTITETI DHE NGJYRESA FETARE DHE AJO E MORALIT...!”

- (El-Gazali, “El-gazvuth-thekafi jemteddu fi feragina” -

E thashë edhe mbrëmë në një bashkëbisedim televiziv, se: “Islami nuk mund të jetë alibi në gojë të të paudhëve!” Nuk mund të fshihet njeri pas emrit të fesë më të madhe në botë, për të përligjur ligësinë, injorancën, vasalitetin ndaj të keqes dhe ushqimin e propagandave çnjerëzore kundër Islamit dhe muslimanëve!

Islami dhe muslimanët, historikisht njihen për të kundërtën e asaj që, qarqe të caktuara antiislame në botë, mundohen t'i prezantojnë, duke mbjellur frikë dhe mungesë sigurie kudo në botë, në kurriz të muslimanëve, të Islamit, të diversitetit fetar që jeton në harmoni, por jo vetëm.

Islami dhe muslimanët nuk kanë prodhur ndonjëherë terrorizëm, që ta prodhojnë sot! Shkodra muslimane, nuk ka prodhuar ndonjëherë terrorizëm me veshje fetare islame, që ta prodhojë

Ndërkohë që të tjerët merren me etiketimin tonë të padrejtë, në një luftë të hapur e të pabarabartë, më lejoni t'ju kujtoj, se në raste lufte, të gjithë ne duhet të kthehemi tek ajeti kur'anor, nëpërmjet të cilit, All-llahu i Madhëruar urdhëron: “O Pejgamber! All-llahu të mjafton ty dhe besimtarëve që janë me ty!” – (El-Enfal: 64.)

Ky ajet ka zbritur në prag të një beteje. Mendoni: mbështetje totale për të Dërguarin dhe besimtarët në prag të një përballjeje me armikun! Edhe ne sot, si ymet islam, përballemi gjithandë me armiqësi të shumta shekullore, në forma e përmbajtje nga më të ndryshmet. Janë plagë të shumta të hapura në trupin e ymetit tonë, padrejtësisht! Por, All-llahu është me ne, sado që ne si besimtarë, do të dijmë të ruajmë madhësinë e harmonisë dhe vëllazërisë islame në mesin tonë! Pa këtë vëllazëri, pa sinqeritetin për ta ndërtuar atë, për ta

ruajtur atë, për ta përhapur në rrethet familjare, tek fëmijët tanë, tek brezi i ri, nuk ka prespektivë!

Sot, më tepër se kurrë, ne kemi nevojë të gjallërojmë vlerat e harmonisë islame në mes nesh. Me fjalë të tjera, kemi nevojë të ndjejmë madhësinë, ngrohtësinë dhe cilësitë e mrekullueshme të vëllazërisë së shenjtë islame në mesin tonë!

Resulull-llahu (a.s) urdhëron e thotë: “Nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa të dojë për vëllanë e tij, atë që do për veten e tij” – (Bukhariu dhe Muslimi.)

Ky është sekreti! Nuk ka rrugë tjetër! Mos fol pas shpine për vëllanë tënd musliman! Mos e prej në besë muslimanin! Mos e shit muslimanin! Mos i bëj padrejtësi muslimanit! Mos të të duket vetja mbi të tjerët, sado gjynahqarë të jenë në sytë e tu se, sytë e tu nuk janë Sytë e Zotit! Ndhmoje dhe përkrahe muslimanin, e ke vëlla!

Imam Neveviu, tekta e shpjegon këtë hadith, thotë: [Ka thënë Imam Ebu Muhammed Ibn Ebi Zejd, imami i malikive të Magribit, në kohën e tij: Përmbledhja e krejt moraleve të së mirës janë katër hadithe: “Ai që beson në All-llahun dhe në jetën e përtejme, të flasë mirë, ose të heshtë!”, “Prej përsosmërisë së Islamit të njeriut, është edhe largimi i tij nga ajo që nuk i përket!”, porosia profetike: “Mos u zemëro!” dhe hadithi: “Nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa të dojë për vëllanë e tij, atë që do për veten e tij”] – (Dr. Mustafa El-Buga dhe Muhjiddin Misto, “El-Vafi fi sherh El-Erbainen-Nevevije”, Damask, pa vit botimi, f. 93.)

Prandaj, le të kthehemi nga thelbi i fesë sonë, ta praktikojmë Fenë e All-llahut, ta dëshmojmë veten si muslimanë krenarë, ta refuzojmë propagandën islamofobe dhe ta kthejmë mbrapsht urrejtjen shekullore ndaj Islamit dhe muslimanëve, kujtudo që ka lidhur besën e tij me shejtanin e mallkuar dhe rrugëton drejt shkatërrimit dhe prishjes në tokë!

Rrugët tona me ato të së keqes, janë ndarë, që kur All-llahu i Madhëruar ka urdhëruar: “Merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve.” – (El-A'rafë: 199.)

All-llahu ju ruajtë e ju dashtë, ju dhuroftë shijen e besimit dhe ju bëftë pishtarë ndriçues në realitetet e hirta të jetës shqiptare!

(Hytbeja e mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 11 nëntor 2016)

SY MË SY ME SHPIRTIN E QYTETIT TIM...

E sotmja, ishte një ditë e veçantë, ndër të bukurat ditë, kur besimi, shpresa dhe optimizmi, lidhur ngushtë me historinë, krenarinë e vlerave të trashëguara dhe tabanin tonë qytetar, bëhen së bashku dhe luten me fytyrën e qeshur nga e ardhmja...

Historia e jonë është e hidhur. E mbushur me persekutim, vafëri, shtypje, padrejtësi pa fund e rrugë të mbyllura. Por, dekadat që kaluan, sidomos ato të periudhës ateiste, përtej histerisë kolektive dhe pabesisë ndaj fesë, vërtetuan se persekutimi i gjyshërve



Sot, vizitova Medresenë e vajzave. Është pa dyshim një hisë e madhe krenarie për Shkodrën. Është pa dyshim një model vlerash dhe suksesi për bashkësinë tonë muslimane. Është pa dyshim një derë e madhe vlerash besimi e dijeje, prej ku pritet shumë e, ku, sytë e zemrat e shumëkujt që ia do të mirën këtij qyteti e këtij vendi, presin e presin me besim, durim e largpamësi lutjesh të sinqerta...

Përkujtuam së bashku 26 vjetorin e rihapjes së Xhamisë së Plumbit. (Në kushte të tjera, këtë takim mund ta bënim edhe te vendngjarja e asaj mirësie të madhe, atij sinjali hyjnor e atij shpërthimi qytetarësh me vlera të pahumbura në realitetet e tyre shpirtërore... Xhamia, nën ujin e përmytjeve të ditëve të fundit, nuk na e mundësonte dot...)

Sot, aty para vajzave me hixhabin ngjyrë flamuri kombëtar mbi koka, më erdhën në mendje shënimet e burrit të urtë, Ahmet Davutoglu, në librin e tij “Qytete dhe qytetërime”, (përkthyer dhe botuar në shqip nga LOGOS-A, Shkup, tetor, 2016), kur thotë: “Ata që humbasin shpirtin e qyteteve të tyre, edhe po ta vazhdojnë dominimin politik, nuk mund të jenë të qëndrueshëm. Kurse ata që u japin shpirtin qyteteve, edhe po ta humbasin dominimin politik e bëjnë të qëndrueshme praninë e tyre në ato vende!”

tanë u bë kurban shpëtimi për shpirtin e këtij qyteti! Dhe, Zoti e pranoi kurbanin e tyre! Pa dyshim që e pranoi!

Fëmijët tanë sot, vajzat me hixhab e djemtë e rinj të përkushtuar ndaj fesë së të parëve të tyre, janë lidhja më e madhe e të sotmes me të djeshmen e lavdishme, kur gjyshërit tanë sakrifikonin dhe punonin për ndërtimin e institucionit të “shpirtit të qytetit”, tabanit të palëkundur të besimit dhe fesë, traditave dhe kulturës, mishëruar në thirrjet e Kur'anit dhe ato të Dërguarit të fundit të Zotit...

Këtë shpirt, e kemi për detyrë ta mbrojmë, sidomos sot, kur po na vërtetohet dita-ditës se historia e pabesive kombëtare mund të përsëritet, nëse ia lejojmë të keqes të shtrijë tentakulat e saj, mbi shpirtin e vlerave tona, mbi tapetin e paqës të tolerancës, pastërtisë, qytetarisë, njerzillekut e ujit të fytyrës...

Sot, ndjeva fort shpirtin e qytetit tim, në fytyrat e bijave tona, që trashëgojnë ma të mirat vlera nga familjet e tyre, që besuan përkundjen e tyre në ma të fismin e ma garantin Djep të Shpirtit të qytetit tonë...

All-llahu ju dashtë e ju pastë në mbrojtje, bijat e Hz. Hadixhe Kubrasë!

Imam Muhamed B. Sytari

Myftini Zonës Shkodër

Shkodër, më 14 nëntor 2016



Sheikh Muhamed El-Gazali

Islami është bindje në zemër, pastërti në qenie, nder në moral dhe lartësim në udhë, sipas asaj që ka thënë i Dërguari fisnik (a.s): “Allahu i do punët e larta dhe i urren punët e pakuptimta” dhe në çdo pëllëmbë të tokës dhe sekondë të kohës mund ta paraqesësh këtë Islam, të nxjerrë nga Libri (Kur’ani), Suneti (tradita profetike), zbatimet e kalifatit të drejtë, interpretimet e imamëve të mëdhenj dhe kuptimet e njerëzve të mençur.

Disa folësa për Islamin janë kritikuar sepse ata i bartin shkencat e tij prej periudhës së mbretërve të provincave, apo mbretërve të memlukëve që nuk dinin as të flisnin, apo politikave të shteteve të vockla, të cilat dolën prej trugut të shtetit abasit, ashtu siç dalin nga trugu i pemës, filiza parazitë, për ta dobësuar dhe jo për ta fuqizuar atë.

Shembulli në dije dhe qeverisje merret prej brezave të parë, e nuk merret prej brezave të mëvonshëm të përhumbur. Kam vënë re disa njerëz që debatojnë ashpër se, konsultimi me njerëzit e ditur dhe ekspertë është thjesht informacion dhe jo i detyrueshëm!

Me ironi thashë: Përse atëherë janë quajtur njerëz të dijes dhe ekspertë? Ka njerëz që qëndrojnë të heshtur e nuk lëvizin aspak, përpara çështjeve të drejtave të njeriut, sepse kjo temë nuk njihet në atë çfarë ka lexuar në libra. Sikur Islami është një terminologji, e cila është shfaqur vetëm në të shkruarën, ndërsa kuptimet, të cilat janë nxjerrë prej Kur’anit Famëlartë dhe janë ngjizur në Sunetin Sherif, nuk kanë lidhje me to...

Ka edhe diçka tjetër. Nuk ka fé, nëse nuk formohet zemra e përkushtuar dhe mendja besimtare, sepse kush humb ndërgjegjen vigjilente dhe mendimin e zgjuar, nuk ka mirësi në të!

SINQERITETI

Edukimi i matur, shpjegimi i vazhdueshëm, këshilla e mirë dhe debati i qeshur, janë më të dobishme për Islamin se sa sharjet dhe armiqtësitë.

Të Dërguarit mbarë ishin të drejtuar nga njeriu, ta drejtojnë e ta edukojnë, larg shkopit të policit! Ata formuan burra e fëmijë, pra prodhuan shoqëri të ndritur e të qëndrueshme, në ditën kur pushteti ishte i idhujtarëve të gurit, apo të njeriut. Ata të cilët janë të paaftë të ndërtojnë këtë lloj shoqërie, është e pamundur të ndërtojnë qeveri islame. Dhe, ata që rezistojnë në ndërtimin e kësaj shoqërie, patjetër do t’i përfshijë ligji i Allahut në urbanizimin njerëzor: “E ndërsa shkuma shkon kot, atëherë ajo që i bën dobi njerëzve, do të qëndrojë në tokë!”¹

Nëse patjetër duhet të pranohet njëfarë dështimi, atëherë unë do të preferoja një popull besimtar të suksesshëm në ndërtimin e tij të një qeverisjeje të keqe, të dështuar në largimin e saj! Ose, sipas përshkrimit të dr. Mustafa Mahmud: “Është më e mirë për Islamin të zërë vend në ndërgjegjen e njerëzve dhe ta drejtojë jetën e tyre, se sa të zënë vend burrat e tij në karriget e pushtetit”.

Besoj se sukcesi i thirrjes (davitit) në përhapjen e sinqeritetit, mëshirës, bashkëpunimit, rregullimit, pastërtisë, aktivizimit dhe dhënies përparësi tjetrit është diçka që nuk mund të çmohet. Këto cilësi morale janë djepi i vërtetë për tu ngritur vetvetiu qeverisja e mirë.

Për sa kohë që vendosëm se qeverisja është pamje e saktë e (gjendjes së) vetë popullit dhe se çështja është ashtu siç e ka thënë Kur’ani Famëlartë: “Kështu Ne i qeverisim disa zullumqarë me disa të tjerë, për shkak të asaj që kanë punuar”².

Kujto se një herë takova një person të zjarrtë në përhapjen e thirrjes (davitit), ashtu siç thoshte, por dyshoja në nijetin e tij dhe vendosa ta sprovtoj!

I thashë: A e do famën?

Tha: Përse jo!

- A do të të tregoj për rrugën më të shkurtër (më efikase) të famës?

Tha: Po.

- Shaj femrat dhe guxo të flasësh

1. Kur’ani, Er-Rad: 17.
2. Kur’ani, El-Enam: 129.

**TË DËRGUARIT MBARË
ISHIN TË DREJTUAR NGA NJERIU,
TA DREJTOJNË E TA EDUKOJNË,
LARG SHKOPIT TË POLICIT,
FORMUAN BURRA E FËMIJË,
PRA PRODHUAN SHOQËRI
TË NDRITUR E TË QËNDRUESHME,
NË DITËN KUR PUSHTETI ISHTË
I IDHUIJTARËVE TË GURIT,
APO TË NJERIUT. ATA TË CILËT JANË
TË PAAFTË TË NDRËTOJNË KËTË LLOJ
SHOQËRIE, ËSHTË E PAMUNDUR
TË NDRËTOJNË QEVERI ISLAME.
DHE, ATA QË REZISTOJNË
NË NDRËTIMIN E KËSAJ SHOQËRIE,
PATJETËR DO T’I PËRFSHIJË
LIQJI I ALLAHUT
NË URBANIZIMIN NJERËZOR:
“E NDËRSA SHKUMA SHKON KOT,
ATËHERË AJO QË I BËN
DOBI NJERËZVE,
DO TË QËNDRONË NË TOKË”**

ndaj pushtetarëve!! Dhe, pas kësaj unë të garantoj ty një pozitë te njerëzit dhe një vend në xhehenem!!

Tha: Po, përse vendi në xhehenem, ndërkohë që unë them të vërtetën.

- E vërteta, nëse me të nuk merret për qëllim kënaqësia e Allahut, bëhet barrë për të zotin që e ka thënë. Kam lexuar një hadith të saktë, që thotë: “Hipokrizia (dyfytërsia) është shirk”.

Tha: A të mahnit ajo çfarë sheh prej shthurjes, fesadit dhe rrëmujës?

- Jo, nuk më mahnit dhe as që luftohet me metodat, të cilat i vepron! Edukimi i matur, shpjegimi i vazhdueshëm, këshilla e mirë dhe debati i qeshur, janë më të dobishme për Islamin se sa sharjet dhe armiqtësitë. Le të jetë Allahu pas nijetit dhe le ta dish se e ardhmja është në dorën e Tij.

*Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:*

Lavdrim Hamja

NA U MBYLL EDHE NJË DERË E MADHE E DIJES...

Ditën e sotme, mora lajmin e dhimbshëm të ndërrimit jetë të njërit prej dijetarëve dhe mendimtarëve më të spikatur të Historisë Islame në rang botëror, Dr. Mervan Shejkhulerd, në Damaskun e zemrës.

Dr. Mervan Shejkhulerd ka qenë mësuesi ynë. Një burrë i urtë, njeri i veçantë, komentues i pashembullt i historisë islame; asaj të Pejgamberit (a.s), emevitëve dhe abasitëve në veçanti. Autor i disa librave, ku spikat mbi të tjerat, vepra me titull: “Historia Profetike – Themelet thirrëse dhe civilizuese”, Damask, 2000.

Teologët e brezit tim, por edhe ata para dhe pas nesh, janë dëshmitarë sesi tejmbushej salla me studentë të krejt viteteve, kur Dr. Shejkhulerd kishte leksion.

Në Damask thuhej se, tre janë baballarët e Historisë Islame: Dr. Sheuki Ebu Khalil, Dr. Suhejl Zekkar dhe Dr. Mervan Shejkhulerd!

Dhe, kam bindjen se, ne që patëm bekimin e Zotit të ishim studentët e tij, e dëshmojmë me zemër e shpirt këtë konstatim të madh, në hak të Mësuesit tonë, që sot u larguar nga kjo botë, drejt jetës së përtejme.

E kemi përkthyer edhe në shqip mendimin dhe gjurmën e Mësuesit tonë, ku në një material që pata sjellë në shqip, nga arabishtja dhe publikuar me 25 korrik të këtij viti, ndër të tjera, ai shkruan: “Prej dëshmimeve më madhështore të natyrës së diversitetit, që All-llahu ka vendosur në natyrë, është edhe diversiteti në njerëz, në popuj, në gjuhë, në ngjyra, në interesa, në vise, në jetëgjatësi, në raca, në cilësi e veçori, në shumësi e pakësi, në dije e injorancë; vërtetësi, që i dëshmojmë në lëvizjen e jetës.

Po të përvetësohen rregullat e natyrës hyjnore, si aleat jetik, ato e shndërrojnë rrjedhën e diversitetit në marsh sukcesi, që i shpëton popujt, grupet etnike dhe racat njerëzore nga prishja, tirania, luftërat dhe fatkeqësitë!

All-llahu i Madhëruar urdhëron: “O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëme popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek All-llahu, më



DR. MERVAN SHEJKHULERD

i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat)! All-llahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” – (Kur’ani, El-Huxhuratë: 13)”

Ndërkohë, në komunikimin e fundit që pata me zotninë e tij, para disa ditësh, teksa e lajmëroja për idenë e përkthimit të një seri shkrimesh nga prodhimtaria e tij, më shkruante:

“Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim.

Inderuar Myftievëlla, Muhamed Sytari.

Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi ve berekatuhu.

Më gëzoi shumë letra jote, këtë mëngjes. Më bëri të hap dosjen e kujtimeve tona, ku vizatohen qartë tiparet e personalitetit tuaj fisnik dhe bashkëshortes tuaj të nderuar, vëllezërve; Vili (Ervil Kuçi), Lavdrim dhe vëllezërve të tjerë shqiptarë, që ishin për mua vëllezër mendje, shpirti e zemre!

Ju falënderoj shumë për përkthimin e shkrimit tim, sikurse shpresoj t’i përktheni krejt shkrimet e mia, sidomos ato që lidhen me të Dërguarit e All-llahut, që fillojnë me Hz. Ademin (a.s) dhe, që mendoj se, përmbajnë një nxitje besimore dhe edukative drejt ndërtimit të qytetërimit njerëzor!

Vëlla Muhamed,

I lutem All-llahut të jeni mirë; ti dhe familja jote, vëllezërit dhe Shqipëria, sikurse lutem për ty të kesh përparim të vazhdueshëm në punën dhe thirrjen tënde elitare!

**Sado që të arrijë
madhështia e burrave në jetën
njerëzore, gjatë gjithë historisë,
e vërteta e institucionit të
thirrjes civilizuese të popujve,
në origjinë kthehet tek ajo,
me të cilën erdhën të Dërguarit
e Zotit (paqja e Allahut qoftë
mbi ta). Ata janë prijësit
udhëzues, të sinqertët
e zgjedhur, të cilët punuan në
kumtimin e asaj çfarë iu zbrit
nga Zoti. Rezultati i punës
të tyre të madhe ishte në atë
pozitë, sa që Allahu e bëri
përvojën e tyre dhe vuajtjet,
sinqeritetin dhe qëllimin e
tyre të pastër ndaj Allahut,
anqazhimin e tyre me detyrat e
ngarkuara, në përqzime dhe në
tërheojen e vëmendjes, shembuj
të përkryer dhe shembuj të mirë
për të Dërguarin e Allahut,
Muhamedin (a.s), vulën
e profecisë, me të cilin,
Allahu plotësoi fenë
dhe plotësoi beqatitë.**

Dr. Mervan Shejkhulerd

Ju falënderoj!

Es-selamu alejkum ve rah etull-llahi ve berekatuhu“


Tashmë, edhe ky mesazh dhe kjo letër malli, nga një Mësues zemre, nga një burrë i madh e studiues elitar, do të rreshtohet në arkivin e “Dyerve të Mbyllura”, prej ku buron mirësia e të shkruarve tanë, para të cilëve kemi lidhur BESËN...

Kushedi edhe sa do të sprovohemi me largimin e Mësuesve tanë nga kjo botë, deri një ditë..., ku lutemi dhe shpresojmë se, të gjithë së bashku do tubohemi tek Burimi i Resulull-llahut (a.s), ku shpresojmë të pjmë prej duarve të tij...

Të mbuloftë All-llahu me Rahmetin e Tij, Ustaz...

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër, 25 nëntor 2016



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

1. Hapën disa arabë të ardhur nga Riadi një shkollë në Cërrik të Elbasanit dhe mbledhën shumë djelmossa me iu mësuar fenë Islame, të cilët ishin të djegur për ta mësuar. Gjë e mirë, mirëpo ata arabë, megjithëse investohen nga bamirësit myslimanë, që kanë medhhebe Hanefi, Shaffi, Maliki e Hanbeli, të ardhurat i shpenzuan për t'i mësuar fëmijëve tonë disa fjalë jashta medhhebeve, si p.sh. me vendosë burri duart mbi gjoks, ose gati deri në fyt, me hapë këmbët, me shpërvjelë fundin e pantallonave etj. Dhe, më e rëndë se këto gjëra, qe se filluan të helmojnë zemrat e fëmijëve kundër baballarëve dhe hoxhallarëve të tyre, duke iu thënë se ata krejt kanë qenë larguar nga besimi, sa që një djalë shqiptar u mor me atë fjalë e tha përpara disa të tjerëve se: babai i tij ishte për zjarr, mbasi ka qenë Hanefi! Ebu Hanifja (r.a.) që ka parë disa sahabe, e medhhebi i tij është i pari i katër Medhhebeve, e më tepër se gjysma e muslimanëve të botës janë Hanefi e, ata janë për zjarr?! I mjeri shpifës!

Ajo shkollë u mbyll, e ajo shoqatë u transferua. Zoti i shpërbleftë me të mirat e veta ata që e përzunë këtë shoqatë e ata njerëz. Por gaca u hodh në tokën tonë (ku të diturit e fesë janë pak) e kam frikë se ajo gacë do të djegë disa letra, gjeth e fletë të lehta dhe do të ndizet me to një zjarr i vogël, por dëmtues, dhe, në qoftë se ai zjarr nuk dëmtton, ashtu i lutemi Zotit (xh.sh), do bëjë tym të mërziqshëm në vendin tonë, por dëshirojmë që të mos zgjasë shumë.

2. Sa mirë është të bashkëpunojnë besimtarët mësues e studentë për të luftuar disa Bidate të mëdha që po përhapen në vende të ndryshme të botës Islame si p.sh. mos interesimi për të ndihmuar për të larguar vuajtjet e të këqijat nga vëllezërit muslimanë kudo që të jenë.

FJALA E FUNDIT MBI SYNËTIN DHE BIDATIN

3. Me u largu nga ata që bashkëpunojnë me armikun kundër vëllezërve të tyre, ku të jenë e si të jenë.

4. Me u përpjekë me plotësu kërkesat e fesë duke bashkëpunuar me vëllezër dhe në qoftë se gjenden disa ndryshime të vogla ndërmjet tyre, si në katër Medhhebet që ndryshojnë nga njëri-tjetri në disa pika, pasi vetë sahabët e Profetit (a.s) kanë pasur ndërmjet tyre disa ndryshime.

5. Me mendu e besu mirë për të tjerët, me besu se edhe ata e duan fenë si ne, e interesohen për fé si ne.

ruajtur fenë gjatë jetës së regjimit komunist në vendin tonë, e kur u hap liria, u ngritën të na mësojnë fenë.

10. Të mundohemi që të mësojmë arabishten si gjuhë feje, se na ndihmon shumë e shumë në kuptimin e Kur'anit, të Hadithit e fjalët e dijetarëve të kaluar.

11. Po, por duhet të bashkëpunojmë kundër injorancës fetare, kundër atyre partive fetare që nuk kanë lidhje të vërtetë me fenë tonë edhe në qoftë se shiten se janë si ne, p.sh. Kadjanija, Behaija, Batinija.

KADJANI (AHMEDI): Janë ata të cilët

Rini, bëhu shpirti, toka, dora, goja e munda i Islamit këtu, që të mësohet mirë feja Islame këtu, për t'u zbatuar, për të jetuar me të, për t'u përhapur si drita e diellit që ndriçon botën me jetë më të mirë dhe shtyn insektet e këqija e dëmtuese, të fshihen ose të fiken përherë.

Thotë Zoti (xh.sh): "Zoti ka dërguar dërguesin e vet me udhëzim të plotë, dhe me fenë e vërtetë që do të triumfojë mbi çdo fe, e mjafton ALL-LLAHU dëshmues".

6. Me besu se myslimani e ka për detyrë të dojë vëllain në fé e se nuk duhet me e humbë vëllazërinë për disa kërkesa të lehta, që ndoshta nuk bien dakord për to.

7. Me e ruajt Medhhebin Hanefi, me mësim e zbatim (tek ne) dhe me dijtë se është Medhhebi i shërbyer nga qindra e mijëra dijetarë në Kur'an, Hadith, Besim e të tjera, se, siç dihet, Ebu Hanifja ka qenë i pari që ka shkruar në Besim dhe ka rregulluar mësimet e Fikhut që merret me Ibadet e lidhje jetese me të tjerët, e se ata që kanë ardhur mbas tij, deri të marrurit më Hadith si Buhariu, kanë vazhduar rregullin e tij.

8. Mos me i vënë veshin disa fjalëve të reja që fliten këndeje e andej si selefi, dijetarë të Hadithit dhe të disa njerëzve që ndoshta shiten se dijnë më mirë se të parët e medhhebeve e dijetarët e Medhhebeve të ndryshëm. Ne duhet të qëndrojmë në medhhebin tonë, mirëpo duhet të mësojmë mirë e më mirë, me fakte e me argumente.

9. Të punojmë për t'i shtuar mësimet fetare në jetën tonë me lëndët e ndryshme të saja, të lidhura nga dija mirë e më mirë, e t'i nderojmë hoxhallarët se ata në të vërtetë e kanë

besojnë se ka ardhë profet mbas Profetit Muhammed (a.s) e kjo gjë është qyfer (blasfemi), mbasi është në kundërshtim me Kur'anin.

BEHAI: Janë ata të cilët besojnë se Zoti (xh.sh.) hynë në trup të të parëve të tyre dhe nuk besojnë në jetën e ardhshme.

BATINI: Janë ata të cilët nuk besojnë në zbatimin e Faljes, Agjërimet e Zekatit, gjë që është në kundërshtim me fenë Islame.

Rini, ti je shpresa e jonë mbas Zotit (xh.sh.) në vendin tonë, ashtu siç ishte Rinia në kohën e Profetit (a.s) dhe në ditët e para të fesë.

Rini, bëhu shpirti, toka, dora, goja e munda i Islamit këtu, që të mësohet mirë feja Islame këtu, për t'u zbatuar, për të jetuar me të, për t'u përhapur si drita e diellit që ndriçon botën me jetë më të mirë dhe shtyn insektet e këqija e dëmtuese, të fshihen ose të shuhën përherë. Thotë Zoti (xh.sh): "Zoti ka dërguar të dërguarin e vet me udhëzim të plotë, dhe me fenë e vërtetë që do të triumfojë mbi çdo fé, e mjafton ALL-LLAHU dëshmues".

VEL-HAMDU LIL-LAHI RAB-BIL ALEMIN!

Shkodër, korrik 1994



Hfz. Mehas Alia

Imam, "El-Hidaje", St.Gallen - Zvicër

Vëllezër dhe motra të nderuara, Shpesh ndodh që njeriu të humbë nga shikimi kohën e shkurtër të kësaj bote dhe të periudhës në të cilën jeton. Për këtë, duhet të mendojmë shumë rreth fjalëve të Allahut (xh.sh), ku thotë: "...ditën kur do ta përjetojnë atë që u është premtuar, atyre u duket sikur nuk kanë jetuar vetëm se në një moment të shkurtër të ditës. Dhe mjaft! A mos shkatërrohet kush, pos popullit të shfrenuar?" - (El-Ahkaf, 35). Allahu i Madhërishëm, po ashtu, thotë: "Ditën kur ta përjetojnë atë, atyre (idhujtarëve) do t'u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj." - (En-Naziat, 46)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s), ishte duke iu mbajtur ders shokëve të tij, as'habëve të nderuar, kurse dielli ishte në majë të kodrës, duke perënduar ngadalë, dhe ai (s.a.v.s) u tha: "Ajo që ka ngelë nga kjo botë, në krahasim me atë që ka kaluar, është njëjtë me atë që ka ngelë nga kjo ditë, në krahasim me atë që ka kaluar prej saj." - (Imam Tirmidhiu, hadithi është vlerësuar si hasen).

Tregohet se dijetari i njohur, Shibiliu,

O NJERI, PUNO PËR DYNJANË AQ SA DO TË JETOSH NË TË!

"Ditën kur do ta përjetojnë atë që u është premtuar, atyre u duket sikur nuk kanë jetuar vetëm se në një moment të shkurtër të ditës. Dhe mjaft! A mos shkatërrohet kush, pos popullit të shfrenuar?" (Kur'ani, El-Ahkaf: 35).

ka mësuar te katërqind dijetarë, prej të cilëve ka mësuar mbi katër mijë hadithe, por, siç ai vetë ka rrëfyer, vetëm një hadith ia ka ndryshuar krejt jetën e tij. Hadithi është ky: Muhammedi a.s. ka thënë: "Puno për këtë botë aq sa do të qëndrosh në të; puno për botën tjetër, aq sa do të jetosh atje; puno për Allahun xh.sh. aq sa ke nevojë për Të; kurse për zjarrin, puno aq sa mund ta durosh atë." - (El-Gazali, "Ej-juhel veled").

Kushdo që prej nesh ia do të mirën vetvetes, le të mendojë shumë për këto hadithe.

O njeri, o ti me logjikë dhe arsye, sa kohë ke kaluar deri tani, të duket e shkurtër apo e gjatë? Po ta pyesim një 90 vjeçar, se sa gjatë i duket se ka kaluar në këtë botë, do të thotë se jeta i është dukur e shkurtër.

Ai i cili kupton drejtë, do të shoh se mund të jetë mashtruar, se akoma është në ëndrra, dhe se lumturinë e përhershme, me mirësitë e vazhdueshme që kurrë nuk mbarojnë, i ka shitur për gjëra të pavlera, që një ditë u vjen fundi dhe zhduken. Sikur të ecte në kërkimin e Allahut dhe të përbotshmes, të asaj që është e përhershme, Allahu i Plotëfuqishëm do t'ia jepte edhe pjesën e tij të dunjasë, madje do t'i jepte mundësinë që të kënaqej në të.

Në disa përcjellje të tjera, është thënë po ashtu: "O biri i Adem, bleje Ahiretin me dunjanë tënde, do t'i fitosh të dyja. Mos e shit Ahiretin tënd për dunjanë, se do t'i humbësh të dyja." -

O biri i Adem, ti je i nevojshëm për pjesën tënde të dunjasë, por më i nevojshëm je për pjesën tënde të Ahiretit. Nëse i jep përparësi pjesës tënde të dunjasë, ke përta shkatërruar edhe Ahiretin, por, me këtë, do të humbësh edhe pjesën e dunjasë. Dije sigurt, se nëse i jep përparësi pjesës tënde të Ahiretit, ke për të fituar me sukses edhe pjesën tënde të dunjasë.

(Ebu Nu'ajmi i përcjell si fjalë të Hasan El-Basirut, me zinxhir të mirë.)

Dijetarët e mëparshëm tonët, thoshin: O biri i Adem, ti je i nevojshëm për pjesën tënde të dunjasë, por më i nevojshëm je për pjesën tënde të Ahiretit. Nëse i jep përparësi pjesës tënde të dunjasë, ke për ta shkatërruar edhe Ahiretin, por me këtë, do të humbësh edhe pjesën e dunjasë. Dije sigurt, se nëse i jep përparësi pjesës tënde të Ahiretit, ke për të fituar me sukses edhe pjesën tënde të dunjasë.

(Hytbeja e xhumasë, e mbajtur, më 09.10.2016, në xhaminë "El-Hidaje", St. Gallen - Zvicër)



INTERVISTË ME IMAMIN E TRENTOS, DR. ABOULKHAIR BREIGHECHE

"NËPËR SHKOLLA ORA E FESË MUSLIMANE" - INTERVISTË ME IMAMIN E TRENTOS: FONDAMENTALIZMI? NJË MENTALITET I DEVIJUAR? NJË INTERVISTË E GJITHËANSHME E IMAMIT BREIGHECHE, I CILI PËRBALLET ME TEMËN E FONDAMENTALIZMIT, EDUKIMIN E TË RINJVE MUSLIMANË DHE NDËRTIMIN E XHAMISË SË TRENTOS. "PËR MOMENTIN NUK KA FONDE, POR INSTITUCIONET MUND TË NA NDIHMOJNË".

Trento: Futja e një ore fakultative të fesë Islame nëpër shkollë përkrah asaj katolike, grushti i shtetit në Turqi, impenjimi i vazhdueshëm kundër fundamentalizmit. Këto ishin disa nga temat të cilat u prekën në intervistën që imami i Trentos, Aboulkhair Breigheche dha për gazetën il Dolomiti.it

- Doktor Breigheche, si i përgjigjeni atyre të cilët akuzojnë përfaqësuesit e muslimanëve që nuk bëjnë mjaftueshëm për të luftuar fundamentalizmin?

- Kush shpreh këtë gjykim do të thotë që nuk e njeh mirë realitetin e qendrave islame që punojnë në terren, në disa raste edhe prej shumë vitesh, me një impenjim jo indiferent. Këto të fundit shpesh zëvendësojnë shtetin në nivele të ndryshme, nga ai social deri në atë edukativ. Impenjimi jonë kundër fundamentalizmit është i vazhdueshëm.

Ne kemi momente të ndryshme gjatë javës, duke nisur nga hytbeja e Xhumasë, e cila përkthehet në italisht rregullisht, ku ne e shfrytëzojmë për të transmetuar mesazhe të forta kundër fundamentalizmit dhe kundër ekstremizmit. Gjithashtu kundër çdo tentative devijimi ose mikrokriminaliteti që mund të ekzistojë nga ana e ndonjë individi. Nuk pranojmë

përgjithësimin. Ne jemi të pastër 100%. Nuk jemi engjëj, jemi persona sikurse gjithë të tjerët. Komuniteti jonë bën pjesë në komunitetin tuaj, së bashku. Ka momente që vuan nga tensioni, por impenjimi është i vazhdueshëm dhe serioz.

- Po atëherë çfarë Islami është ai i cili predikohet nga persona të cilët bëjnë atentate si ato të cilat kemi parë nëpër shumë vende Evropiane ?

- Ka vetëm një Islam: ai i paqes, i vëllazërisë dhe i solidaritetit dhe dashurisë për tjetrin. Çdo gjë tjetër nuk është Islam por një mentalitet i devijuar, komplet i jashtëm në mënyrën më absolute nga kultura islame. E gjitha, fryt i një lavazh truri nga ana e atyre, të cilët shfrytëzojnë fenë.

- Sot rinia e komunitetit tuaj kur shkojnë në shkollë a e ndiejnë nevojën e një leksioni për fenë Islame ?

- Sigurisht që e ndiejnë. Kjo është për shkak të mungesës të rregullit të të drejtave dhe detyrave të qytetarëve të fesë Islame. Kjo mungesë, për fat të keq, përjashton qytetarët e fesë Islame, të rinjtë në shkollë (në rastin konkret), për të pasur një të drejtë të tyren që të mësojnë fenë. Ne jemi të hapur për çdo formë që të përdorim këtë leksion. Kam vënë re në raste kur

është prezent një mësues i fesë katolike që ka një mentalitet të hapur, disa familje muslimane i lenë fëmijët e tyre që të marrin pjesë në atë orë leksioni.

Në gjithë këtë, gjithsesi rregulli do të ndihmonte shumë mësimin e fesë islame që të dali në dritën e diellit, ashtu siç duam ne.

- Në një moment historik si ky që po përjetojmë, cila është frika juaj më e madhe ?

- Jam shumë i shqetësuar për mënyrën me të cilën Evropa dhe në përgjithësi Perëndimi po sillen kundrejt minorancave islame. Është duke u përgjithësuar, duke arritur deri në atë pikë sa të konsiderohet prezenca islame në perëndim, si një rrezik.

Për fat të keq shembujt e asaj që po ndodh në disa raste janë edhe qesharake, duke nisur nga detyrimi që të hiqet mbulesa nga kokat e grave në Francë ose në rastin e fundit të ndalimit të veshjes së një kostumi banjoje për të notuar!?

- Polemikët e këtij sezon pushimi për sa i përket perçeve. Ju çfarë mendimi keni?

- Theksoj që është banale dhe e rëndë njëkohësisht. Dikush i jep format e shprehjes fetare shumë tradicionalisht, por ajo është e



rëndësishme në jetën e njerëzve, duke u përballur seriozisht me problemin e përjashtimit, të getizimit dhe të pranimit pozitiv në komunitet. Shqetësimi jonë është ndjenja kundra Islamit. Një ndjenjë e përgjithësuar dhe tashmë tepër e frekuentuar, e cila e bën atë që i përket besimit islam person të kategorisë B.

- Para disa ditësh, në gazetën tonë, peshkopi Tisi tha që liria e kulteve vlen për të gjithë. Një hapësirë drejt ndërtimit të një xhamie në Trento të cilës iu bashkuan edhe disa mendime të botës politike.

Si ka mundësi që jeni ju muslimanët që jeni të vakët në këtë çështje?

- Ne si minorancë fetare do të donim absolutisht një vend kulturi për adhurim, një xhami të vërtetë dhe të duhur. Por për momentin si besimtarë të fesë Islame nuk mundemi të përballojmë shpenzimet, duke konsideruar dhe shpenzimet e të hollave që kemi mbledhur për qeranë e lokaleve të Qendrës Islame në Gardolo, si dhe për sistemimin e saj. Ideja e një xhamie mbetet një dëshirë e fortë, institucionet duhet ta shqyrtojnë këtë çështje bashkë me ne dhe bashkë me të gjithë njerëzit e tjerë që kanë vullnetin e mirë.

Ka disa përvoja në territorin nacional, ku institucionet kanë kontribuar ekonomikisht dhe si pasojë bashkëpunojnë në menaxhimin e aktivitetit.

Aktivitetet që ne si komunitet islam çojmë përpara janë të shumta dhe shpeshherë nuk njihen. Kemi sektorin e rinisë, i cili është një lule në gonxhe.

Janë universitarë dhe licealë që kanë takimet e tyre javore dhe të pavarura. Pastaj është impenjimi i rëndësishëm i femrave dhe aktivitetet e dëgjimit të cilat menaxhojmë përditë.

- Në Danimarkë falja e Xhumasë është prirë nga dy gra imame. Kjo është një temë tepër e debatuar në brendësi të fesë Islame, ju si e mendoni?

- Janë disa rregulla precize. Nuk ka asnjë limit për pjesëmarrjen e grave në brendësi të komunitetit islam, nga mësimdhënia deri në edukim. Ne si Shoqatë Islamike Italiane e Imamëve dhe drejtuesve fetarë kemi dëshiruar që 25 % e themeluesve të ishin gra dhe gati 30 % të ishin në fushën e drejtimit. Për të drejtuar gjatë një faljeje mbetet gjithmonë e drejtë ekskluzive e burrave. Gratë mund të jenë imame ose të prijnë vetëm për gratë e tjera.

- Në grushtin e shtetit në Turqi ju jeni shprehur si mbështetës i presidentit Erdogan.

- Një person i lirë dhe demokratik nuk mund të jetë në anën e puçistëve që duan të marrin pushtetin jashtë votave të rregullta dhe demokratike. Në të njëjtën kohë, unë jam gjyqtar, nuk jetoj në Turqi dhe nuk jam politikan, por shoh që shoqëria civile, opozita dhe parlamenti, në formacionet e saj të ndryshme, jam dakord në atë që po ndodh në Turqi pas grushtit të shtetit. Do të thotë që sistemi gjyqësor po bën gjëra të rregullta. Shpresa është që të mos abuzohet me këtë sistem.

Përktheu nga italishtja:

Ervil Kuçi

(marë nga: ildolomiti.it, 8 shtator 2016)



"Unë besoj se sprovat e mëdha, të cilat i kanë goditur muslimanët në kohën tonë, kanë qenë edukim, pastrim, ndriçim dhe mësim prej Allahut për një fazë që do të vijë më pas, në të cilën do të shfaqen prijësit e vërtetë, të cilët janë formuar nga sprovat dhe janë pjekur nga edukimi hyjnor. All-llahu na përgatit për diçka..."

Dr. Mustafa Mahmud,

AKTIVITETE TË BEGATA GJATË MUAJIT NËNTOR



XHAMIA SULTAN AHMET KALON NJË RESTAURIM GJITHËPËRFSHIRËS

Pas tre dekadash do të bëhet restaurimi i radhës i Xhamisë së Kaltërt në Stamboll, ndërkohë që ky restaurim paraqet atë më gjithëpërfshirës në historikun e saj 400-vjeçar.

Xhamia Sulltan Ahmet e cila është e vetmja xhami nga periudha Osmane që ka gjashtë minare është një detaj i pashmangshëm në kartolinat e Stambollit.

Nga shkaku i ngjyrës së kaltër që dominon dhe pllakave dhe mbishkrimeve quhet Xhamia e Kaltërt, ndërsa është ndërtuar në vitin 1616 me urdhër të sulltanit Osman, Ahmed I.

Drejtori i Administratës, Adnan Ertem deklaroi për AA se janë bërë të gjitha përgatitjet dhe puna do të fillojë në pranverë. "Restaurimi i Xhamisë së Sulltan Ahmetit do të jetë restaurimi i fundit i yni në Stamboll", tha Ertem sipas të cilit kanë përfunduar ose janë në fazën finale të gjitha xhamitë e tjera të qytetit.

"Nga restaurimi i fundit i Xhamisë Sulltan Ahmet kanë kaluar 30 vite dhe ky do të jetë njëri nga më gjithëpërfshirësit", sqaroi ai për të



shtuar se problem shtesë paraqesin ujërat nëntokësorë. "Nëse shfaqet nevoja do të ndërtojmë kanale për bartjen e ujit. Ky do të jetë dallimi nga restaurimi i cili është bërë 30 vite më parë", tha Ertem.

Ertem rikujtoi se kanë restauruar më parë një minare, dhe se tani kanë vendosur të bëjnë riparim të gjerë të minareve të tjera, në të cilat janë vërejtur dëmtime.

Ai nënvizoi se janë vjedhur shumë

pllaka të vlefshme të xhamisë. "Më parë nuk është gjetur një zgjidhje për hapësirat boshe të cilat kanë mbetur të tilla. Këshilli për monumentet ka gjetur zgjidhje për këto pllaka që të zëvendësohen me të ngjashme", tha Ertem për të shtuar se gjatë punimeve xhamia do të jetë e hapur për lutjet e besimtarëve.

Punimet restauruese pritet të përfundojnë në vitin 2020.

www.radiojehona.al

HAFIZJA E PARË E KURANIT NË KËSHILLIN BASHKIAK NË BEH

Hfz. Nermin Çakiq ka lindur në Travnik. Pas përfundimit të arsimit fillor regjistrohet në medresenë Elçi Ibrahim-Pasha në Travnik. Në prill të vitit 2009, si studente e medresesë, nën mbikëqyrjen e prof. hfz. Fadil Bektash përfundon hifzin e Kur'anit të Shenjtë, dhe kështu bëhet hafizja e parë e Kur'anit nga Medreseja e Travnikut.

Në vitin 2014 diplomon në Fakultetin e Studimeve Islame në Sarajevë dhe fiton titullin profesor i teologjisë islame. Studimet pasuniversitare i përfundon në të njëjtin universitet dhe aktualisht është në proces të zhvillimit të tezës master. Si studiuese angazhohet në bibliotekën e Gazi Husrev-beut, në arkivin e Bashkësisë Islame.

Në zgjedhjet e fundit lokale, hfz.

Nermin ishte kandidat për Këshillin Bashkiak në Novi Travnik. Me 505 vota të fituar, bëhet anëtare dhe kështu arrin dy suksese, si gruaja e parë me shami

në Këshillin Bashkiak në Novi Travnik dhe hafizja e zgjedhur në një këshill bashkiak në gjithë vendin.

www.radiojehona.al



MEJTEPI IM... XHAMIA KULLAJ, POSTRIBË

PAK HISTORI:

- Xhamia Kullaj, ndodhet në zonën e Postribës dhe përbëhet nga rreth 350 familje, të gjitha me përkatësi islame. Fiset më të mëdha janë: Bushaj dhe Bajraktari.

- Pas rilejimit të besimit islam në vendin tonë, xhamia është ndërtuar në vitin 1995. Ndërsa rindërtimi i saj me parametra bashkëkohorë është realizuar në korrik, 2016.

- Kanë shërbyer si imamë dhe mësues të mësim-besimit në periudha të ndryshme: Eqerem Ademi, Elez Bajraktari (Brahimi), Seit Hoxha, Ekrem Abdiu, Altin Nikshiqi, Ermal Dibra, Jetmir Braqi, Shukri Taka, Kujtim Cufaj dhe aktualisht Ardin Selhani.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar 11 kurset fetare të besimit nga periudha e hapjes së sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në prill 2002 e deri më tani është: **374** nxënës.



për mirëmbajtjen e këtyre aktiviteteve mjaft të rëndësishme arsimore dhe edukative.

Kursi i ri ka rreth 9 muaj që ka filluar, zhvillohet dy herë në javë dhe marrin

për atë që besojnë dhe që aplikojnë nga adhurimet islame.

"Arritja e këtij misioni është atëherë kur pas mbarimit me sukses të mejtepit të vihet re se nxënësi apo nxënësja e xhamisë fillon të jetë për shoqërinë ku jeton një shembull i mirë në besimin dhe moralin e pastër që përçon vazhdimisht dritën hyjnore dhe harmoninë me të gjitha krijesat e Zotit Fuqplotë...", -tha ndër të tjera teologu Arben Halluni në bisedën e mbajtur enkas me nxënësit e xhamisë Kullaj...



TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vazhden e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit me nxënësit e xhamive të Shkodrës që frekuentojnë kurset mejtepe e mësim besimit, drejtuesi i tij, teologu Arben Halluni më 04.11.2016 zhvilloi një takim pune dhe inspektimi në xhaminë Kullaj.

Përpara se teologu Halluni të mbante një bisedë me nxënësit e xhamisë, ai evidentoi ecurinë e tyre mësimore, pjesëmarrjen, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami z. Ardin Selhani dhe nevojat që ka xhamia

pjesë rreth 50 nxënës të moshave nga 11 – 17 vjeç (djem dhe vajza), të ndara në tre grupe. Gjithashtu vlen të përmendet se nxënësit ndjekin një program të rregullt mësimor. Në të zhvillohen lëndët si: Ilmihal, Kur'an-abetare dhe Edukatë Islame.

Drejtesia e arsimit në bisedën e tij para nxënësve kërkoi prej tyre që t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë kësaj veprimtarie arsimore, duke e frekuentuar vazhdimisht kursin-mejtesin fetar, por edhe duke dalë prej tij si besimtarë të mësuar dhe të bindur



Paraditën e së martës, më 1 nëntor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga një pjesë e stafit të Myftinisë Shkodër, zhvilloi një inspektim në terrern për të parë nga afër dy prona të shenjta vakëf në lagjen e vjetër të Tabakut, Qafë.

Fillimisht, Myftiu pa nga afër vakëfin e Tabakut, ku ndodhet edhe gjurma shekullore e xhamisë së vjetër. Pavarësisht kërkesave të shpeshta dhe komunikimeve me Bashkinë dhe gjyqet e shumta, akoma rruga drejt vakëfit të Tabakut ngelet e bllokuar si pasojë e ndërtimeve private.

Poashtu, u konstatua se mbi kanalin shkarkues të ujrave që mblidhen te xhamia e Plumbit, janë hedhur inerte të pakontrolluara, duke shkaktuar bllokimin e tij.

Edhe për këtë fakt, janë bërë komunikimet e duhura me Bashkinë dhe pritet, që ky institucion të ndërhyjë sa nuk është tepër vonë.

Myftiu inspektoi edhe punimet për rrethimin e vakëfit të varrezave të Qafës, mbi kodrën e xhamisë së Plumbit, një pronë shumë e rëndësishme për

INSPEKTOHEN DY PRONA ME RËNDËSI PËR KOMUNITETIN E MUSLIMANËVE



komunitetin e muslimanëve të Shkodrës.

Duke parë mos përgjigjen e shtetit, gjykatave, Bashkisë etj, në kërkesat legjitime të institucionit tonë, këto ditë Myftinia Shkodër po ndërmerr masa për pastrimin dhe lirimin me krejt mundësitë e

saj të vakëfeve të shenjta të nëpërkëmbura nga institucionet e vendit tonë!

Myftinia Shkodër fton besimtarët të marrin pjesë në thirrjet e saj, si dhe fton qytetarët të mirëkuptojnë këtë lëvizje të Myftinisë Shkodër.

MYFTIU DHE IMAMËT: “JANË DHUNUAR KREJT XHAMITË E SHKODRËS, SOT!”

Pasdreknë e së martës, më 8 nëntor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim të gjatë pune me imamët e qytetit të Shkodrës, me të cilët diskutoi zhvillimet e ditëve të fundit në qytetin e Shkodrës.

Ky takim pune vjen në vazhden e diskutimit dhe trajtimit të fenomeneve negative, me të cilat po përballlet opinioni publik dhe masat muslimane në qytetin e Shkodrës.

Myftiu diskutoi edhe mbi shoqërimin e një grupi qytetarësh muslimanë, nga policia e shetit, ditën e shtunë, më 5 nëntor 2016.

Myftiu tha se ka dënua dhe dënon maksimalisht tendencat e kujtdo, që përpiqet të mbjellë farën e keqe dhe të rrezikshme të islamofobisë dhe dasive fetare në Shkodër, si rasti i lajmit të “shoqërimit të disa muslimanëve për sigurinë e një meshe” në Shkodër!

Ai tha se nuk ka musliman në Shkodër a në botë, që i shkon ndër mend të merret me meshat a aktivitetet fetare të komuniteteve të tjera fetare, aq më tepër të mendojë cënimin a prishjen e tyre!?

Ai tha se Myftinia Shkodër e konsideron këtë përpjekje, banale dhe abuzive me frymën e Islamit 15 shekullor, që kudo dhe historikisht ka rrezatuar vlera humane,



tolerancë ndaj komuniteteve të tjera fetare dhe aftësi për të tejkaluar situatat abuzive me të drejtat dhe liritë e individit dhe shoqërisë!

Njëkohësisht, dënoi përpjekjet për ta prezantuar Islamin jashtë rrobës së tij, si dhe fushatat e egra të ekstremizmit laik dhe radikalizmit islamofob në vendin tonë, që vetëm se nxisin urrejtje dhe mbjellin injorancë, me të cilat Islami është i ndarë!

U dënua maksimalisht edhe dhunimi i bërë mëngjesin e sotëm, i objektit të xhamisë së Madhe në Fushë Çelë, Shkodër. Myftiu theksoi se, duhet të marrim masa

për mbrojtjen e xhamive tona nga injoranca e jashtme, islamofobia e organizuar dhe tendencat për denigrimin e imazhit të Islamit në vendin tonë!

“Janë dhunuar krejt xhamitë e Shkodrës, sot!” -, u theksua nga të pranishmit.

Në këtë takim u diskutua edhe për fenomenin e përmytjeve të frikshme të ndodhura në vendin tonë, ditën e sotme, ku u dha udhëzim, që pas namazeve ditore dhe ditën e xhuma, të organizohen lutje masive dhe të ftohen njerëzit drejt paqimit me Zotin e gjithësisë!

PROMOVHET PËRMBLEDHJA E VEPRËS “SAHIHUL-BUHARI”



Paraditën e së shtunës, më 12 nëntor 2016, Myftinia Shkodër, organizoi një tribunë shkencore në kuadër të promovimit të veprës së Imam Buhariut, përmbledhja e së cilës është përkthyer dhe botuar edhe në gjuhën shqipe.

Imamë, intelektualë, drejtues të shoqatave islame, të rinj dhe besimtarë të shumtë shprehën interesimin e tyre për këtë aktivitet, që vjen edhe në kuadër të përkujtimit të 26 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë, më 16 nëntor 2016, pas periudhës së gjatë të persekutimit gjysëmshkullor mbi Islamin dhe muslimanët në Shqipëri.

Në këtë aktivitet referuan, teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”, Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, teologu Ruzhdi Plangaj, imam i xhamisë Kiras, si dhe përshëndeti aktivitetin, H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe.

Gjatë kësaj tribune shkencore, u evidentuan vlerat dhe madhështia e Imam Buhariut, si një ndër personalitetet më të shquara të historisë islame, vepra e të cilit mbetet pikë referimi për mbarë


ymetin islam.

Imami i shquar dhe muhadhithi më i famshëm i shekujve, Muhammed ibn Ismail El-Buhari, u lind në vitin 194 h., në qytetin e Buharasë, që sot bie në Republikën e Uzbekistanit.

Arritja kryesore e aktivitetit të tij dituror, është pa dyshim libri i tij: “Es-Sahih”, për shkrimin e të cilit na tregon: “E kam shkruar “Sahihun” në një periudhë prej 16 vjetësh, hadithet e të cilit i kam nxjerrë nga gjashtëqind mijë hadithe. Ky libër është argument në mes meje dhe All-llahut të Madhëruar”

Imam Buhari u lind ditën e xhuma, pas namazit të xhumasë në të trembëdhjetën ditë të muajit Shevval, në vitin 194 h. dhe vdiq natën e shtunë, në prag të namazit të jacisë, natën e Fitër Bajramit. U varros pas namazit të Bajramit, të shtunën e 1 Shevvalit, në vitin 256 h. Jetoi 62 vjet, pa 13 ditë.

Të pranishëmve në këtë aktivitet, Myftinia Shkodër i dhuroi botimin e përmbledhjes “Sahihul-Buhari”.



ËMBËLSIA E BESIMIT

Enesi (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

**“Tre gjëra kush i ka,
ai ka gjetur ëmbëlsinë
e besimit:**

- 1. Allahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashur se asgjë tjetër.**
- 2. Njeriu të dojë dikë, por të mos dojë, vetëm se për hir të Allahut.**
- 3. Të urrejë të kthyerit në kufr (mosbesim), ashtu siç urren të hidhet në zjarr.”**

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

MEDRESEJA E VAJZAVE, PËRKUJTOHET 26 VJETORI I RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT

Ditën e hënë, më 14 nëntor 2016, Myftinia Shkodër organizoi në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", dega e vajzave, një aktivitet përkujtimor me rastin e 26 vjetorit të rihapjes së Xhamisë së Plumbit.

Aktiviteti u përshëndet nga drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, i cili vlerësoi rihapjen e Xhamisë së parë në Shkodër, si një kthesë e rëndësishme e kthimit nga vlerat e besimit në Shqipëri.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, i cili iu drejtua medresistëve me një mesazh të ngrohtë, duke i quajtur si: "bijat e Hz. Hadixhe Kubrasë".

Myftiu theksoi se 16 nëntori 1990 dëshmon se Zoti i gjithësisë nuk e humbi besimin dhe lutjet e gjyshërve dhe baballarëve të persekutuar, por e pranoi persekutimin e tyre si një kurban besimi dhe shpirti për krejt qytetin e Shkodrës.



Më pas u shfaq dokumentari: "Triumfi i zanit të minareve", prodhim i Myftinisë Shkodër, me rastin e 25 vjetorit të rihapjes së Xhamisë së Plumbit.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga koordinatori i Shoqatës "Istanbul", teologia Elona Sytari, e cila pasi falënderoi Myftiun për këtë vizitë dhe

mesazhet e saj, uroi që fryma e paqte e mësimëve të fesë islame të vazhdojë e të përhapet gjithandej në vendin tonë, si bekim nga Zoti.

Më parë, Myftiu zhvilloi një takim edhe me znj. Valjeta Bajraktari, nëndrejtores e degës së vajzave, si dhe drejtoi faljen e namazit të mesditës.

MYFTIU VIZITOI KOORDINATORIN E RI TË TIKÀ-S

Paraditën e së martës, më 15 nëntor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në selinë e TIKÀ-s, në Tiranë, ku uroi Koordinatorin e saj të ri për Shqipërinë, z. Eyup Yavuz Umutlu.

Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu e uroi z. Umutlu për detyrën e re dhe shprehu dëshirën e tij që TIKÀ të jetë sa më shumë prezente në Shqipëri me projekte të dobishme, që lidhin edhe më shumë dhe forcojnë urat shekullore të vëllazërisë dhe bashkëpunimit në mesin e dy popujve tanë.

Myftiu theksoi se Turqia është sot, arteria kryesore e zhvillimeve të ymetit islam, sikurse tha se, bashkëpunimet e institucioneve fetare dhe jo vetëm, në mesin e dy vendeve, duhet të shtohen, në rrugën e forcimit të mëtejshëm të tyre, në shërbim të vlerave të përbashkëta shekullore dhe shpirtit



të qytetërimit islam, të ndërtuar me shumë përkushtim e mund nga gjyshërit tanë shekuj më parë.

Nga ana e tij, z. Umutlu falënderoi Myftiun e Shkodrës për vizitën dhe shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim të përzemërt.

TAKIM PUNE ME KRYETAREN E BASHKISË SHKODËR

Paraditën e së enjtes, më 17 nëntor 2016, përfaqësuesit e Myftinisë Shkodër, z. Arben Halluni dhe z. Lavdrim Hamja, zhvilluan një takim pune në Bashkinë e Shkodrës, ku u pritën nga Kryetarja, znj. Voltana Ademi me stafin e saj.

Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e Myftinisë Shkodër prezantuan disa nga problematikat e vakëfit dhe shqetësimet e institucionit të muslimanëve të Shkodrës, në lidhje me shumë çështje të pazgjidhura, si: lirimi i vakëfeve në Zdralej, në Rus, në Zogaj, te teatri "Migjeni" etj.

Përfaqësuesit e Myftinisë Shkodër, shprehën njëkohësisht se përtej faktit se këto probleme ka vite e vite që trajtohen nëpër gjykata, zyra shtetërore, Bashki etj., dhe përtej faktit se në të shumtën e rasteve e drejta legjitime dhe e fituar



ligjërisht është e Myftinisë Shkodër, asgjë nuk është bërë deri më sot për lirimin dhe pastrimin e këtyre vakëfeve të shenjta.

Nga ana e saj Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, shprehu

angazhimin dhe gatishmërinë e saj dhe të Bashkisë Shkodër për krijimin e një grupi pune për ndjekjen me detaje të secilës prej kërkesave legjitime të Myftinisë Shkodër dhe zgjidhjen e tyre.

NËNKRYETARI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË, Z. GAZMEND AGA, TAKIM PUNE NË MYFTININË SHKODËR

Paraditën e së enjtes, më 17 nëntor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim pune, Nënkrjetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Gazmend Aga, që shoqërohej edhe nga z. Astrit Zharri, Drejtor i Arsimit në KMSH dhe z. Oltion Kola, Drejtor i Medies në KMSH.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu informoi Nënkrjetarin Aga për aktivitetin e gjerë të Myftinisë Shkodër, zhvillimet e reja të vakëfit, pozitën dhe qëndrimet e Myftinisë Shkodër ndaj realiteteve dhe situatave të ndryshme sociale, kulturore, fetare, ndërfetare e përtej tyre. Myftiu theksoi se përtej angazhimeve të përditshme për të mundësuar rikthimin e vakëve në identitet, ka një mungesë së besimit tek institucionet e drejtësisë dhe ato shtetërore, që po zvarrisin prej dekadash çështjen e vakëve tona.

U zhvillua një analizë e detajuar e aktivitetit fetar, arsimor, botues, thirrës



e bamirës të Myftinisë Shkodër, ku u dhanë informacione të dokumentuara e të arkivuara mbi ecurinë e punës në terren.

Nënkrjetari Aga, konfirmoi edhe një herë angazhimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në rrugëtimet

e tij për ruajtjen e interesave të muslimanëve dhe përmirësimin e infrastrukturës së Thirrjes Islame në rang kombëtar. Ai theksoi se po punohet maksimalisht për çështjen e pronave si dhe rritjen e nivelit të prezantimit të mesazheve në publik.

“IMAMËT, PISHTARË TË UDHËZIMIT”, SEMINAR ME IMAMËT E SHKODRËS

Paraditën e së martës, më 22 nëntor 2016, Myftinia Shkodër organizoi seminarin me temë: “Imamët, pishtarë të udhëzimit”, ku merrnin pjesë imamët e Myftinisë Shkodër.

I ftuar special i këtij seminari me vlerë, ishte studiuesi islam dhe thirrësi i afirmuar nga Jordania, Dr. Xhemal Safarti.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga z. Lauren Luli, kryevaiz i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në fjalën e tij, z. Luli theksoi se përgjegjësia e imamëve në kultivimin e vlerave islame dhe përkujdesjen ndaj tyre është shumë e madhe.

Më pas, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi imamët e pranishëm për kontributet e tyre të vazhdueshme, edhe në kushte të vështira. Ai tha se imamët e Myftinisë Shkodër janë shembull pozitiv edhe në rang kombëtar, për punën e vazhdueshme dhe rezultatet e dëshmuara në shërbimet e Thirrjes Islame.

Myftiu përgënjeshtroi lajmet e përhapura nga ndonjë prej mediave kombëtare, se në Shkodër ka xhami



jashtë juridiksionit të Myftinisë. “Nuk është aspak e vërtetë ajo që keni dëgjuar nga media se në qytetin tonë ka xhami jashtë juridiksionit tonë! Ky është një banalitet, me të cilin po luhet trashë në rang kombëtar! Dhe, do të theksoj edhe një herë para jush, se modelet e shërbimeve të prodhuara kryesisht nga imamët tanë, vlejnë si shembull kombëtar!” - tha Myftiu i Shkodrës.

Më pas, Dr. Xhemal Safarti, mbajti një leksion plot vlera, ku shpjegoi rolin e imamëve në përhapjen e vlerave

islame, edukatën, moralin, durimin dhe shembullin e të jetuarit me Islam në shoqëri.

“Imami është personaliteti kryesor i botës tonë islame, pikëreferimi ynë, mësuesi ynë, shembulli për t'u pasuar në çdo moral, sjellje e fjalë! A e justifikojmë sot, ne si imamë këtë përgjegjësi?” - theksoi Dr. Safarti.

Seminari vazhdoi me ndërhyrjet e imamëve, bashkëbisedimet dhe pyetje-përgjigje rreth temës.

MYFTIU: “IMAMËT E SHKODRËS, SHEMBULL KOMBËTAR!”

Gjatë seminarit të ditës së sotme, më 22 nëntor 2016, në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed B. Sytari, theksoi se, “Nuk është aspak e vërtetë ajo që keni dëgjuar nga media se, në qytetin tonë ka xhami jashtë juridiksionit tonë! Këto janë propaganda dashakeqe, që kanë për qëllim frikësimin e njerëzve dhe njollosjen tonë!

Ky është një banalitet, me të cilin po luhet trashë në rang kombëtar, duke u përfolur muslimanët si burim konflikti, pasigurie e frike në vend!

Dua të theksoj edhe një herë para jush, se modelet e shërbimeve të prodhuara kryesisht nga imamët tanë, vlejnë si shembull kombëtar!



Natyrshëm, ka ende shumë për të bërë e përmirësuar në punën tonë, por asses nuk ia lejojmë askujt të fusë

hundët në punët tona të brendshme a të njollosë imazhin tonë!” - tha Myftiu i Shkodrës.

MYFTIU PRITI KRYETAREN E KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET, ZNJ. ALIKO

Paraditën e së mërkurës, më 23 nëntor 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim prezantimi, Kryetaren e re të Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko.

Gjatë këtij takimi, Myftiu theksoi qëndrimin e Myftinisë Shkodër, në

drejtim të ruajtjes së vlerave shekullore islame në vend, mbartjen e simboleve fetare dhe mos tolerimin e cënimit të tyre, për asnjë arsye.

Njëkohësisht, i uroi punë të mbarë dhe suksese, kryetares së re të Komitetit Shtetëror për Kultet.




DITËN E 28 NËNTORIT 2016, MYFTINIA SHKODËR NË NDIHMË TË FAMILJEVE NË NEVOJË

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari zgjodhi familjen Sulaj nga fshati Stom Golem i njësisë administrative Rrethina për të dhënë mesazhin e 28 Nëntorit.

Myftiu i Shkodrës tha se, përkujtimi më i mirë i këtyre ditëve të mëdha e të shtrenjta kombëtare është ndihma ndaj familjeve në nevojë. Ai ftoi

përfaqësuesit e institucioneve dhe qytetarët që të japin kontributin e tyre në ndihmë të kësaj familjeje.

Familja Sulaj, në fshatin Golem, jeton në kushte tepër të vështira ekonomike, pasi asnjëri prej 10 anëtarëve të kësaj familje nuk është i punësuar, madje dy prej të fëmijëve të mitur të familjes Sulaj vuajnë nga probleme të mëdha shëndetësore.



TRANSMETOHET NGA
Ebu HURËJRA (R.A) SE
I KA THËNË
I DËRQUAR I ALLAHUT (A.S):

“PËRHAPË SELAMIN,

USHQË TË VARFRIT,

mbaj lidhjet

ME FAREFISIN

dhe falu NATËN

KUR NJERËZIT

JANË NË GJUMË,

PASTAJ DO TË HYSH

NË XHENET

I SIQURT”.

(TRANSMETUAR NGA Ibn Hibbani)



KALENDARI I AKTIVITETEVE "NË HAPAT E RESULULL-LLAHUT (A.S)"

Shkodër, Rebiulevvel 1438 - Dhjetor 2016

12 dhjetor 2016 pas iqindisë - 14.00, xhamia "Ebu Bekr"	1 TRIBUNË FETARE: "MËSHIRË E DHURUAR..." - Fjala e hapjes nga imami i xhamisë, <i>teologu</i> Idmir Plaku - Përhëndetja e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari - Ligjëratë nga: H. Gilman Kazazi
13 dhjetor 2016 ora: 10.30, te salla e konferencave e Medresesë	2 AKTIVITET ME NXËNËSIT E MEDRESESË "HAXHI SHEH SHAMIA" - Hapja me pjesë kuranore - Fjala e hapjes, Drejtori i Medresesë - Fjala e Myftiut të Shkodrës - Fjala e Kryetarit të Shoqatës "Istanbul" - Ligjëratë nga teologu Ervil Kuçi
14 dhjetor 2016 ora: 17.00, në bibliotekën e qytetit	3 TRIBUNË SHKENCORE MBI AKTIVITETIN E HAFIZ ALI ULQINAKUT Imam Muhamed Sytari, Myfti i Zonës Shkodër Mr. Ali Bardhi, Kryeimam i Ulqinit Arben Halluni, teolog - Lexim i ca pjesëve nga "Mevludi"
15 dhjetor 2016 pas akshamit - 16.20, në xhaminë e Parrucës	4 DERS ME TEMË: "RINGJALLJA E TRADITAVE ISLAME" - Imami i xhamisë, Durim Kasemi - Teologu Lavdrim Hamja
16 dhjetor 2016	5 MEXHLIS SALAVATI DHE LEXIMI I SURES "EL-KEHF" Pas namazit të sabahut - (06.15), në xhaminë e Tophanës
17 dhjetor 2016 pas akshamit - 16.21, në xhaminë e Dërgutit	6 DERS ME TEMË: "MË I MIRI PREJ JUSH, ËSHTË AI QË E MËSON KUR'ANIN DHE UA MËSON ATË TË TJERËVE" - Imami i xhamisë, Ervil Kuçi - Teologu, Adem Pizga
18 dhjetor 2016 ora: 11.00, në hotel "Colosseu"	7 TRIBUNË FETARE: "PËRKUJDESUNI PËR GRATË TUAJA" - Fjala e hapjes: Teologjia Ferzet Ndoja Albina Nanaj – "Gruaja si faktor progresi" Klodiana Smajlaj – "Gruaja myslimane në ruajtje të identitetit"
19 dhjetor 2016 pas namazit të mesditës - 11.45	8 "MEXHLIS HADITHI SHERIF" - në xhaminë e Perashit Lexime dhe komentime nga: "40 hadithet e Imam Neveviut".
20 dhjetor 2016 pas akshamit - 16.22	9 "MEXHLIS HADITHI SHERIF" - në xhaminë e "Dy Vajzave" Lexime dhe komentime nga: "Sahihul-Buhari".
21 dhjetor 2016 pas namazit të akshamit - 16.23	10 DERS ME TEMË: "MË I MIRI NDËR JU ËSHTË MË I MIRI ME FAMILJEN E TIJ" - në xhaminë e Dudasit - Imami i xhamisë, Adrian Uraj - Teologu Arben Halluni
22 dhjetor 2016 ora 10.30	11 VIZITË NË KOPSHTIN: "AROMË TRËNDAFILI" Myftiu me një grup imamësh dhe këshilltarësh
23 dhjetor 2016 pas iqindisë - 14.04, xhamia "Ebu Bekr"	12 "MIRËNJOHJE..." Nderim dhe vlerësim për imamë dhe muezinë ndër vite...
24 dhjetor 2016 ora: 10.00, në bibliotekën e qytetit	13 PROMOVIM I LIBRIT: "MINBER", nga Imam Muhamed Sytari - Diskutojnë: H. Gazmend Aga, (nënkryetari i KMSH) - Teologu Lavdrim Hamja - Fjala e autorit
25 dhjetor 2016 pas namazit të mesditës - 11.45	14 "KËNDIM MEVLUDI TRADICIONAL", në xhaminë e Plumbit

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org